

VENDIM
Nr. 728, datë 16.11.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 235, DATË 20.4.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE
PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2022”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 235, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2022”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pozicionet, në të cilat mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil, për nivelin e mesëm drejtues, gjithsej 12, si edhe për nivelin e ulët drejtues, gjithsej 36, përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Në ndarjen I, “Niveli i mesëm drejtues dhe të barasvlershëm”, të lidhjes nr. 1, bëhen këto ndryshime:

a) Emërtesat e përmendura në pikat 3 dhe 8, zëvendësohen, si më poshtë vijon:

“3. Drejtor në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kategoria II-b;

8. Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, kategoria II-b;”.

b) Pas pikës 9 shtohen pikat 10, 11 dhe 12, me këtë përmbajtje:

“10. Koordinator në sektorin (Zyra) e menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm, në Kryeministri, kategoria II-b;

11. Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria II-b;

12. Drejtor i Drejtorisë së Pagesave dhe Dëmshpërblimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria II-b.”.

3. Në ndarjen II, “Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm”, të lidhjes nr.1, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) emërtesa e përmendur në pikën 19 zëvendësohet me “Drejtor i Qendrës së Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve, kategoria III-a”;

b) pas pikës 26 shtohen pikat 27 deri 36, me këtë përmbajtje:

“27. Drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, kategoria III-a.

28. Drejtor në Drejtorinë e Teknologjive Bujqësore, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë, kategoria III-a.

29. Përgjegjës në Sektorin e Shëndetit, Mirëqenies së Kafshëve dhe Farmakovigjilencës, në Drejtorinë e Veterinarisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, kategoria III-a/1.

30. Përgjegjës në sektorin e zbatimit të masave profilaktike dhe IR, në Drejtorinë e Veterinarisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, kategoria III-a/1.

31. Sekretar i Përgjithshëm në administratën e Prefektit të Qarkut Tiranë, kategoria III-a.

32. Përgjegjës i sektorit të procedurave koncesionare, në Drejtorinë e Koncesioneve, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Përputhshmërisë, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria III-a.

33. Përgjegjës i sektorit të koordinimit për integrimin evropian, në Departamentin e Administratës Publike, kategoria III-a.

34. Përgjegjës i sektorit të qirave dhe monitorimit të kontratave, në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Shtetërore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria III-a.

35. Inspektor në sektorin e monitorimit të koncesioneve/PPP dhe procedurave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në Drejtorinë Juridike dhe Monitorimit të Procedurave, në Agjencinë e Prokurimit Publik, kategoria III-a/1.

36. Drejtor i Organizimit dhe Vlerësimit në Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve, kategoria III-a.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku